



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.19

Prishtinë, më 10 prill 2018, në orën:10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivković, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili, Arban Abrashi, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Nga Komisioni për Buxhet dhe Financa morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Ali Lajçi, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i propozimeve për hartimin e draftligjit për transmetuesin publik të Kosovës;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës-Prishtinën;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i propozimeve për hartimin e draftligjit për transmetuesin publik të Kosovës

Nait Hasani, njoftoi anëtarët e Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa për arsyen e ftesës në komision, duke i cituar nenet e draftit të hartuar për të cilat Komisioni Funkcional nuk ka hartuar propozim pa konsultimin me Komisionin për Buxhet dhe Financa. Çështjet për diskutim ishin: parapagimi për të cilën çështje Komisioni Funkcional propozoi që parapagimi për RTK-në të jetë burim kryesor financiar i transmetuesit publik, ndërsa për çështje të veçanta, si transmetimi i futbollit ndërkombëtar etj, themeluesi të ndanë shumë të caktuar të buxhetit sipas arsyeshmërisë dhe kërkoi mendimet dhe propozimet e tyre për çështjet në fjalë.

Lumir Abdixhiku, tha se ndarja e buxhetit për RTK-në është një barrë e rëndë për buxhetin e Kosovës, ndërsa lidhur me propozimet për hartimin e draftit për P/ligjin për RTK –në, propozoi formën që parapagimi të jetë direkt tek konsumatori, për një aparat televiziv, për çdo shtëpi dhe fatura të jetë vjetore, por duke shfaqur domosdoshmërinë e skanimit të gjendjes reale të financimit, kufizimin e reklamave ose definimin e minutave për reklama, sepse nëse RTK-ja definohet si transmetues publik, duhet të ndërpriten aktivitetet komerciale dhe moslejimin e marrjes së çfarëdo kredie.

Safete Hadërgjonaj, duke kundërshtuar formën e parapagimit nëpërmjet faturës së energjisë si dhe që numrat me përqindje, siç janë në ligjin aktual të mos inkorporohen në tekstin e draftit. Ajo përkrahu propozimin që parapagimi për RTK-në të bëhet me faturë shtëpi për shtëpi, ndërsa që për ngjarjet e veçanta, kampionatet etj, të ndahet buxhet për transmetuesin sipas kërkesave të arsyeshme.

Imet Rrahmani, kërkoi nga Komisioni për Buxhet, që të propozojnë ndonjë model tjetër të parapagimit dhe kërkoi që propozimi për marrjen e kredisë nga RTK të fshihet.

Enver Hoti, pyeti, lidhur me koston që do të kërkojë kompania e energjisë po që se përcaktohet që parapagimi të realizohet përmes faturës së energjisë elektrike.

Fikrim Damka, u deklarua për formën e kombinuar, ndërsa që për parapagimin të zgjedhën disa modele.

Shqipe Pantina, u deklarua për formën e kombinuar, domethënë që pas mbledhjes së parapagimit ti ndahet buxhet shtesë.

Xhevahire Izmaku, duke kundërshtuar propozimin për heqjen e reklamave, ajo propozoi që reklamat të kufizohen në minutazhë, sepse kjo është praktikë standarde edhe për televizionet e vendeve të rajonit.

Valon Ramadani, përkrahu diskutimin e Lumir Abdixhiku dhe u deklarua se është kundër që parapagimi të rimburohet përmes faturës së energjisë.

Milaim Zeka, propozoi që buxheti për RTK-në të jetë i përcaktuar dhe i detajuar në vija të ndara për TV, Radio dhe redaksitë, me qëllim të shmangies së keqpërdorimeve.

Nait Hasani, propozoi që të shqyrtohen edhe opsionet që parapagimi të rimburohet me fatura të tjera të shpenzimeve të infrastrukturës, gjithashtu i propozoi Komisionit për Buxhet dhe Financa se nëse kanë propozime për çështjet që u diskutuan të vazhdojnë me takime të përbashkëta.

3.Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës-Prishtinën;

Komisioni shqyrtoi disa propozime për nenin 4 dhe nenin 7 të P/ligjit dhe pas shqyrtimit të propozimeve, miratoi propozim amendamentin për nenin 4 dhe nenin 7 si vijon:

Amendamenti 2

Neni 4, riformulohet si vijon:

4.1. Kryeqyteti i Republikës së Kosovës është Prishtina.

4.2. Kryeqyteti historik i Republikës së Kosovës është Prizreni.

Amendamenti 3

Neni 7, titulli i këtij neni ndryshohet si vijon: “**Kompetencat për Kryeqytetin**”.

Neni 7, paragrafi 1, ndryshohet si vijon:

1. Kryeqyteti, përveç kompetencave të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, ushtron edhe këto kompetenca:

1.1.1. Kryetari i Kryeqytetit pas aprovimit nga Kuvendi i kryeqytetit themelon Drejtorinë e Policisë të kryeqytetit në kuadër të Strukturës Organizative të Kryeqytetit, me detyra dhe përgjegjësi vetëm për Kryeqytetin;

1.1.2. Kuvendi i Kryeqytetit i propozon kryetarit të Kryeqytetit dy kandidatë për drejtor të Drejtorisë së Policisë të kryeqytetit, i cili emëron njërin nga ta për drejtor të Drejtorisë së Policisë të Kryeqytetit;

1.1.3. Kuvendi i Kryeqytetit ushtron mbikëqyrjen e politikave lokale të Policisë së Kryeqytetit të cilat bien në kompetencë të kryeqytetit;

1.1.4. Kuvendi i Kryeqytetit ka të drejtë të kërkojë nga drejtori i Policisë së Kryeqytetit të raportojë lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e Policisë Lokale të Kryeqytetit;

1.1.5. Me kërkesën e kryetarit të kryeqytetit, Policia e Kosovës në pajtim me Ligjin për Policinë, mbështetë Policinë Lokale të Kryeqytetit në raste emergjente;

1.1.6. Organizimi, detyrat dhe përgjegjësit e Policisë të Kryeqytetit, më hollësisht rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

1.1.7. Këshilli i Kryeqytetit për Siguri është organ këshillues i kryesuar nga kryetari i Kryeqytetit dhe anëtarë që janë përfaqësues të të gjitha komuniteteve përbrenda kryeqytetit.

Mbledhja përfundoi në orën: 12:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani